EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8043
E martë, 29 prill 2025
Çmimi 0. 50 €

## Sot përpjekja e tetë për konstituimin e Kuvendit
FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# RASHITI: PARTITË POLITIKE JANË TË OBLIGUARA TA GJEJNË KONSENSUSIN PËR FORMIMIN DHE KONSTITUIMIN E KUVENDIT



Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, Naim Rashiti, ka thënë se ngërçi institucional që ka përfshirë Kuvendin e Kosovës pas zgjedhjeve të fundit, po zgjatet në mënyrë të rrezikshme, duke thelluar krizën politike dhe duke e vendosur vendin në një rrugë të pasigurisë kushtetuese. Ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se partitë politike janë të obliguara ta gjejnë konsensusin për formimin dhe konstituimin e Kuvendit. "Zgjidhja më e mirë është që Lëvizja Vetëvendosje të dalë me tre emra për kryetar të Kuvendit dhe një prej tyre domosdo do të duhej të votohej nga opozita", ka thënë Rashiti

## PA GRADIME, ZYRTARË POLICORË MBAJNË POZITA NË TË CILAT S'JANË EMËRUAR
F. 3



## KOSOVA LËSHON FLETARRESTIM NDAJ RADOÇIQIT PËR KRIME LUFTE
F. 7



## OPINION

### E VËRTETA NUK GJYKOHET
F. 6

Shkruan:
Hisen BERISHA



## AKTUALE



### PROCESI I ZGJEDHJES TË PAPËS SË RI DO TË NISË MË 7 MAJ
F. 2

### PUTINI BËN THIRRJE PËR ARMËPUSHIM TREDITOR ME UKRAINËN
F. 2

## EKONOMI




### BANKA BOTËRORE PARASHIKON RËNIE EKONOMIKE NË KOSOVË DHE NË SHQIPËRI
F. 8

### POSTA E KOSOVËS HAP ZYRË TË RE NË LEPOSAVIQ
F. 8

## SPORT



### SONTE GJYSMËFINALJA E PARË NË MES TË ARSENALIT DHE PSG-së
F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Putini bën thirrje për një armëpushim treditor me Ukrainën

**Moskë, 28 prill** - Presidenti rus Vladimir Putin njoftoi për një armëpushim treditor në luftën e Ukrainës që përkon me festimet vjetore që shënojnë mposhtjen e Gjermanisë Naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore.
Zyrtarët ukrainas nuk janë deklaruar ende lidhur me këtë propozim të shpallur nga Kremlini më 28 prill.
Është hera e dytë këtë muaj që Kremlini bën thirrje për armëpushim; armëpushimi i propozuar gjatë festës së Pashkëve kryesisht u injorua, pasi Rusia dhe Ukraina vazhduan të godasin njëra-tjetrën.
Armëpushimi i propozuar tani përkon me Ditën e Fitores, një nga festat më të rëndësishme në Rusi dhe Ukrainë. Më 9 maj shënohet 80-vjetori i mposhtjes së Gjermanisë Naziste.
Ashtu si çdo vit që ka shërbyer si president i Rusisë, Putini do ta kryesojë paradën ushtarake në Sheshin e Kuq që feston rolin sovjetik në mposhtjen e Gjermanisë. Në vitet e fundit Putini e ka përdorur këtë rast për ta lavdëruar historinë sovjetike dhe ruse si dhe për ta sulmuar Perëndimin.
Festimi ndodh ndërkohë që pushtimi rus i Ukrainës - që tashmë është bërë lufta më e madhe tokësore në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore - po vazhdon pa ndërprerje në vitin e tij të katërt. Dëmet e pësuara nga Rusia, në të vrarë dhe të plagosur, tashmë janë më të mëdha se të gjitha humbjet që ka pësuar në të gjitha konfliktet që ka luftuar që nga viti 1945.
Përpjekjet për të arritur një armëpushim bilateral, ose edhe një marrëveshje më të gjerë paqeje, u përshpejtuan



kur presidenti amerikan, Donald Trump, mori detyrën në janar, duke premtuar se do t'i përfundonte luftimet brenda 24 orëve.
Paraardësi i tij, Joe Biden, refuzoi të angazhohej në bisedime thelbësore me Moskën për sa kohë që pushtimi vazhdonte.
Edhe pse Trumpi ka hapur bisedime të drejtpërdrejta me Moskën, zyrtarët rusë kanë kërkuar t'i zgjerojnë negociatat për të përfshirë jo vetëm konfliktin në Ukrainë, por edhe marrëdhëniet më të gjera dypalëshe midis Uashingtonit dhe Moskës.
Rusia dhe Ukraina ranë dakord për një armëpushim të kufizuar në mars, por të dyja palët kanë vazhduar ta sulmojnë njëra-tjetrën. Në fushëbetejë, forcat ruse kanë shfrytëzuar avantazhin e tyre për t'i lodhur trupat ukrainase.
Gjatë fundjavës, në margjinat e funeralit të Papa Françeskut në Vatikan, Trumpi pati takimin e tij ballë për ballë me Volodymyr Zelenskyn e Ukrainës që nga shkurti, kur bisedimet në Zyrën Ovale u ndërprenë me mosmarrëveshje.
Trumpi tha se takimi i tij me Zelenskyn kishte shkuar mirë, por shtoi se mendonte se Zelensky ishte i gatshëm ta dorëzonte Gadishullin e Krimesë ndaj Rusisë si një koncesion - diçka që lideri ukrainas ka deklaruar prej kohësh se nuk do ta bënte kurrë.
"Oh, kështu mendoj", u përgjigj Trumpi. "E shoh [Zelenskyn] më të qetë", tha ai. "Mendoj se ai e kupton situatën, dhe mendoj se dëshiron të bëjë një marrëveshje".
Më pas Trumpi i bëri thirrje Putinit t'i "ndalojë të shtënat" dhe të pranojë një marrëveshje paqeje. "Epo, unë dua që ai t'i ndalojë të shtënat, të ulet dhe të nënshkruajë një marrëveshje", u tha Trumpi gazetarëve.
Zelensky tha se biseda e tij me Trumpin përfaqësonte një "takim shumë simbolik që ka potencial të bëhet historik, nëse arrijmë rezultate të përbashkëta".
Ekspertët thonë se Putini ka zvarritur bisedimet sepse forcat e tij kanë momentumin në fushëbetejë dhe një armëpushim në vijën aktuale të kontaktit do ta linte Rusinë pa arritur një nga qëllimet e tij kryesore: kapjen e plotë të katër rajoneve ukrainase që Moska pretendon se i ka aneksuar: Donjeckun, Luhanskun, Zaporizhjan dhe Hersonin.
Ata shtojnë se dorëzimi i territorit ndaj Rusisë do të ishte politikisht dhe kushtetutshmërisht i pamundur për Zelenskyn. Qytetarët dhe ligjvënësit ukrainas duket se janë fuqishëm kundër idesë.
Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, tha se një marrëveshje për t'i dhënë fund pushtimit rus ishte "më afër" arritjes.
Rusia dhe Ukraina "janë në përgjithësi më afër sesa kanë qenë ndonjëherë gjatë tre viteve të fundit", tha Rubio në një intervistë për "NBC News" të transmetuar më 27 prill. Por, kritika e Trumpit ndaj Putinit erdhi gjithashtu pak pasi ai bëri deklaratën e tij më përfundimtare deri tani për nevojën që Ukraina të dorëzojë territor. Ai tha në një intervistë për revistën "Time", të publikuar më 25 prill, se "Krimea do të mbetet me Rusinë."
Rusia dëshiron që çdo marrëveshje paqeje ta njohë kontrollin e saj mbi pothuajse 20 për qind të Ukrainës, duke përfshirë Krimenë. Ajo gjithashtu kërkon që Ukraina të çmilitarizohet dhe të mbahet jashtë NATO-s. Moska ka refuzuar kërkesën e Kievit për një forcë paqeruajtëse perëndimore që do të monitoronte çdo marrëveshje armëpushimi.
Zyrtarë evropianë dhe demokratë amerikanë kanë kundërshtuar disa nga propozimet amerikane.
Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, më 27 prill tha se Kievi nuk duhet të pajtohet me propozimet amerikane që do ta përfshinin dorëzimin e tokës ndaj Rusisë.
Kaja Kallas, përfaqësuesja e lartë e BE-së për punët e jashtme dhe politikën e sigurisë, tha se do të ishte gabim që Shtetet e Bashkuara të konsideronin mundësinë e njohjes së Krimesë së pushtuar si territor rus si pjesë e një marrëveshjeje paqeje. "Krimea është Ukrainë", theksoi Kallasi, duke shtuar se BE-ja nuk do ta njohë kurrë gadishullin si pjesë të Rusisë.

# Procesi i zgjedhjes të papës së ri do të nisë më 7 maj

Vatikan, 28 prill - Kardinalët katolikë, që u takuan në Romë të hënën, vendosën që më 7 maj të nisë konklava apo procesi për zgjedhjen e pasardhësit të Papa Françeskut, tha zëdhënësi i Vatikanit, Matteo Bruni.
Kardinalët do të marrin pjesë në një meshë solemne në Bazilikën e Shën Pjetrit, pas së cilës do të mblidhen në Kapelës Sistine dhe përmes votimit të fshehtë do të mund të votojnë për zgjedhjen e papës së ri.
Papa Françesku, 88-vjeçar, kreu i Kishës Katolike, vdiq më 21 prill, pas një sulmi në tru. Vitet e fundit ai ishte përballur me probleme shëndetësore, ndërkaq në muajt e fundit të jetës ishte shtruar edhe në një spital në Romë për shkak të pneumonisë së dyfishtë.
Ati i Shenjtë u varros në Vatikan më 26 prill, ceremoni që mblodhi mijëra besimtarë, klerikë dhe udhëheqës nga e mbarë bota.
Varrimi i Papa Françeskut i hapi rrugë mbajtjes së konklavës. Procesi i përzgjedhjes së papës është tepër i fshehtë dhe asgjë nuk do të jetë e sigurt derisa të dalë tymi i bardhë nga oxhaku i Kapelës Sistine, për t'i treguar botës se është zgjedhur një papë i ri.
Në këtë proces, kardinalët që janë nën moshën 80-vjeçare mund të votojnë për kreun e ri të Kishës Katolike Romake.
Pas caktimit të datës për nisjen e konklavës, apo këshillit të fshehtë, kardinalët, që udhëheqin departamente të rëndësishme në Vatikan dhe dioqeza në mbarë botën, do të nisin të mblidhen në Romë.
Emërimi i një pape mund të bëhet vetëm nga kardinalët. Sipas të dhënave të Vatikanit, nga 252 kardinalë, 135 prej tyre janë kardinalë votues nën moshën 80-vjeçare 108 nga këta kardinalë me të drejtë vote ishin emëruar nga Françesku, 22 nga paraardhësi i tij, Benedikti XVI, dhe Gjon Pali II.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# PA GRADIME, ZYRTARË POLICORË MBAJNË POZITA NË TË CILAT S'JANË EMËRUAR




**Prishtinë, 28 prill** - Prej më shumë se pesë vjetësh, procesi i gradimeve në Policinë e Kosovës është bllokuar. Edhe pse ka vende të lira në pozita kyçe, ato aktualisht mbulohen nga zyrtarë që nuk e kanë gradën që parashihet për atë pozitë. Kjo gjë ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e hierarkisë dhe në qartësinë komanduese brenda institucionit, sipas ish-drejtorit të këtij institucioni, Reshat Maliqi.
“Atje janë disa këshilltarë kolonelë të cilët mbajnë pozitë pa u emëruar, e më herët kanë qenë drejtorë rajonalë apo diçka e ngjashme. E tash [mbajnë pozitën e] këshilltarit dhe askush nuk interesohet as se a vijnë në punë, a punojnë. Janë pa asnjë përgjegjësi. Nuk e këshillojnë askënd”, thotë për “Radion Evropa e Lirë”, Reshat Maliqi, i cili sapo është pensionuar.
Raporti i fundit i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) konstaton se 185 zyrtarë policorë janë sistemuar në pozita për të cilat nuk e kanë gradën përkatëse. Një vit më parë kishin qenë 39 sosh. Por, Policia e Kosovës insiston se kjo situatë nuk ka ndikuar në punën e këtij institucioni.
“Këto pozita janë mbuluar me zyrtarë me nga një gradë më të ulët, konform Udhëzimit Administrativ të marrëdhënies së punës në PK”, thotë zyra për media e Policisë së Kosovës.
Vetë ky institucion thotë se një nga arsyet kryesore të mungesës së gradimeve ka qenë situata e sigurisë në veriun e Kosovës, i banuar me shumicë serbe. Megjithatë, në një përgjigje për “REL”-in, Policia e Kosovës thotë se është e gatshme ta rifillojë procesin e gradimit, por shton se “pas rekomandimit të dhënë nga Inspektorati i Policisë së Kosovës, ne jemi në pritje të miratimit të Udhëzimit Administrativ për procedurën e gradimit për zyrtarët policorë”. Megjithatë, kjo situatë nuk sqarohet kaq thjesht nga të gjithë.
Një pjesëtar i Policisë së Kosovës, që kërkoi të mbetet anonim, thotë se procesi është i padrejtë dhe me ndikime politike. “Më është bërë shumë e padrejtë, pasi atëherë konkurrova për gradën ‘major’. Nuk e di pse nuk jam zgjedhur. Më duket se nuk i kam pëlqyer ndoshta dikujt”, thotë ai për “REL”-in, duke treguar se për këtë çështje është në proces gjyqësor.
Ai shton se e njëjta gjë u ka ndodhur edhe disa kolegëve të tij. “Dikujt i shkelen të drejtat e dikush ndoshta po avancohet e nuk e meriton”, thotë ai.
Me situatë të ngjashme thotë se është përballur edhe ish-drejtori i Policisë së Kosovës, Reshat Maliqi. “Unë kam qenë bartës i pozitës së drejtorit, por kur kam qenë drejtor nuk ka qenë askush i politikës, mirëpo edhe në atë kohë nuk iu ka pëlqyer qëndrimi im dhe për një periudhë të shkurtër më kanë thënë që nuk je më aty. Më kanë shkarkuar brenda natës”, thotë Maliqi.
Edhe ish-drejtori tjetër i Policisë, tash deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rashit Qalaj, shpreh kritika për vonesat në gradime. “Kjo situatë na sjell te pyetja pse dështoi [konkursi]? Kush e kërkoi? Pse nuk u ndëshkua askush? Kjo situatë nuk ka ndodhur asnjëherë më parë. Dhe mendoj se kjo ka ndodhur për shkak të ndikimeve që ka bërë ministri [në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla]”, thotë ai.
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës i mohon këto pretendime, duke theksuar se nuk bëhet fjalë për asnjë lloj ndikimi nga politika, por se qëllimi është që gradimet të zhvillohen mbi bazën e meritës dhe në përputhje me nevojat operative.
Konkursi për të cilin aludon Qalaj ishte hapur në fillim të vitit të kaluar për 355 vende të lira për gradën “rreshter”. Por, ky proces u anulua pasi që, sipas një raporti të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), gjatë konkursit ishin bërë lëshime.
Raporti i IPK-së konstatonte se nuk janë bërë verifikimet e nevojshme mbi të kaluarën e kandidatëve, për të garantuar që ata përmbushnin kriteret lidhur me historikun disiplinor e penal.
Për më tepër, në raport u evidentuan edhe mospërputhje të tjera me udhëzimet administrative, si lejimi i aplikimit nga pjesëtarë të gjeneratës së 54-t të cilët nuk kishin përmbushur kriterin e qëndrimit dyvjeçar në gradën “polic i lartë”.
Sipas burimeve të “REL”-it brenda Policisë së Kosovës, kërkesa më e madhe është pikërisht për gradën e rreshterit, për të cilën ekzistojnë mbi 300 pozita të lira.
Herën e fundit kur janë bërë gradime ishte në vitin 2020, kur ishin emëruar 131 togerë. Një vit më parë, më 2019, ishin graduar nëntë majorë dhe 64 kapitenë.
Policia e Kosovës aktualisht ka mbi 10 000 punonjës aktivë, duke përfshirë zyrtarët policorë dhe personelin mbështetës.
Në gusht të vitit 2024, 448 kadetë të gjeneratës së 60 përfunduan trajnimin dhe iu bashkuan këtij institucioni.

# PËRPJEKJA E TETË PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT



**Prishtinë, 28 prill**- Sot (e martë) në orën 10:00 do të mbahet vazhdimi i tetë i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Të dielën që lamë pas, deputetët nuk kanë arritur ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës, pasi kandidatja e partisë fituese, Lëvizja Vetëvendosje, për kryetare të Kuvendit propozoi prapë Albulena Haxhiun.
Gati tre muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, procesi ka ngecur për shkak të mospajtimeve mes disa prej partive më të mëdha parlamentare për pozitën e kryetarit të Kuvendit.
Konstituimi i Kuvendit, i nisur më 15 prill, po dështon për shkak se Vetëvendosja nuk po arrin t'i sigurojë votat e nevojshme prej 61 për kandidaten për kryetare, Albulena Haxhiu. Vetëvendosje i ka 48 ulëse nga 120 sa i ka Kuvendi i Kosovës dhe Haxhiu i mori vetëm 57 vota të dielën.
Deputetët e opozitës së deritanishme thanë të dielën se kjo gjendje tregon se Kurti nuk i ka votat as për krijimin e qeverisë së re.
Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e akuzoi Vetëvendosjen pas seancës se po e mban “peng” vendin duke këmbëngulur për ta propozuar vetëm Haxhiun.
Edhe deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, tha se Vetëvendosja nuk ka votë as për Haxhiun dhe as për ndonjë kandidat tjetër. Ajo bëri thirrje për një marrëveshje politike mes LV-së dhe partive të tjera, por jo me LDK-në.
Ndërkaq Vetëvendosje ngul këmbë se Haxhiu është kandidate meritore dhe, përkundër se ka bërë thirrje për marrëveshje politike, ka hedhur poshtë mundësinë e propozimit të ndonjë kandidati tjetër pos saj.
Hekuran Murati, deputet i Vetëvendosjes, tha se konstituimi i Kuvendit po pengohet nga ata që votojnë kundër kandidates së tyre për kryeparlamentare, “e jo nga ne që votojmë për të”.
Murati tha se Vetëvendosja mund të bëjë kompromis me partitë e tjera vetëm për kandidatët për nënkryetarë, por jo edhe për kryetar të Kuvendit.
Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të hapet rruga për formimin e qeverisë së re.
Vetëvendosje i fitoi zgjedhjet e 9 shkurtit, me rreth 42 për qind të votave, apo 48 ulëse. E për formimin e qeverisë së re asaj i duhen të paktën 61 vota.
Pas LV-së më së shumti vota fitoi PDK, 24 ulëse, pastaj LDK-ja 20 sosh. AAK dhe Nisma i fituan tetë ulëse, prej të cilave tri i takojnë kësaj të fundit.

# PSE OPOZITA DUHET TA VOTOJË KRYETARIN/EN E KUVENDIT



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Lojë e pandershme në pandershmërinë institucionale:** Për shtatë herë radhazi ka dështuar konstituimi i Kuvendit të Kosovës shkaku se LV-ja këmbëngul që Lenka Haxhiu të zgjidhet kryetare e Kuvendit e opozita ka mendim tjetër prandaj refuzon ta votojë. Ka marrë në thua Lenka në numrin e 57 votave, pamjaftueshëm ta kalojë Rubikonin. Marioneta numër një e Kurtit që po i "udhëheq" seancat e Kuvendit, Avni Dehari luajti lojëra të palejueshme për të mundësuar zgjedhjen e marionetës numër 2 për kryetare të Kuvendit. Sa poshtë ka ra katundi! Po flitet se Albin Kurthi po e rrënon reputacionin dhe "emrin e mirë" të kandidates për kryetare të Kuvendit duke e djegur në një zjarr të shkurtër siç janë votimet në Kuvend. Aspak e vërtetë; Kurthi vetëm po e trajnon për një fazë të mëvonshme sipas modelit "Avni Dehari". Lenka e ka pranuar rolin me përkushtim, "besnikëri" dhe nënshtrim ndaj Partisë së mos-Punës LV-së. Lenka nuk e ka problem reputacionin sepse ka bagazh të "fuqishëm" profesional, integritet të pa (k)thyeshëm dhe kapital të madh të shërbimeve ndaj partisë dhe Liderit Suprem. As EXFIS-i nuk do të kishte mundësi të fuste më shumë gaz lotsjellës se që e bëri Lenka Haxhiu prandaj mbështetur në parimet e meritokracisë, me asgjë nuk mund të kundërshtohet! Në planin intelektual dhe profesional i kisha do dyshime (kush jam unë që dyshoj) por deklarimet publike të autoriteteve intelektuale dhe profesionale si dhe vlerave të pariciklueshme njerëzore, kombëtare, politike dhe morale si Dilmal Basha, Faton si Peci, Haxhi Qamili, ekstazitë e Perzerenit, Mef Bajçina, Alil Tači, paramilitari dhe mercenari i Ministrisë së Financave në me krye "nobelisten" Arbërie Pambuku më larguan çdo dyshim, jam për Lenkën, kryetare, sekretare, arkatare, administratore, prokurore, notere dhe përmbaruese e kësaj maratone të turpshme të quajtur mos-konstituimi i Kuvendit të Kosovës.

**Çfarë dëmi mund të shkaktojë Lenka:** Në rrethana tjera do të bënte shumë dëm, në raportin aktual të forcave asgjë hiç! Përveç se do të bëhej një marionetë jofunksionale. Albin Kurthi nuk i ka votat për KM prandaj e hedhë Lenkën si zaret për të bllokuar procesin. Krakitjet e pozitës se kinse opozita po e bllokon zgjedhjen e kryetarit / es së Kuvendit nuk vlejnë as për pesë cent sepse opozita nuk e ka detyrim të sigurojë vota për pozitën shkaku se partia e Albin Kurthit kurrë dhe në asnjë rast nuk e kishte votuar kandidatin e mëparshëm të pozitës së atëhershme për kryetar të Kuvendit. Kadri Veselin Albin Kurthi e kishte quajtur person kontrovers kurse Lenka Haxhiu e pati quajtur kriminel themeluesin, luftëtarin e orëve të para të UÇK-së dhe bartësinë e posteve të larta shtetërore, njeriun me merita të jashtëzakonshme për shtetin e Kosovës, Kadri Veselin. Aktualisht opozita ka një epërsi politike, të numrave, kreditit moral dhe kombëtar prandaj duhet, vullnetarisht dhe pa kushte të zhbllokojë procesin e konstituimit të Kuvendit që po bllokohet pikërisht nga pozita e që nënkupton se bllokuesi përcaktues është Albin Kurthi. Albin Kurthi ka një qëllim, Lenka Haxhiu po përdoret si mjet për arritje të këtij qëllimi që kryeképut është marrja dhe mbajtja e pushtetit.

**Ta shohim gjendjen aktuale:** Opozita e ka nxjerrë në lendinë dhe fushë të hapur Kurthin duke e lënë lakuriq, si mbretin në përrallat e Andersonit në numrin e 57 votave, numër i gurëzuar në të gjitha votimet e deritashme. Pamjaftueshëm për Lenkën Spiropali si dhe për Kurthin KM numër 3. Duhet të jam i sinqertë dhe ta pranoj se që nga përfundimi i luftës nuk kemi pasur Kuvend që ka mbajtur seanca më të rregullta; më parë rrallëherë mbanim 3-4 seanca brenda muajit, tash kemi seanca të rregullta çdo 48 orë. Ky ritëm i seancave i përshtatet Kurthit, aspak opozitës. Opozita duhet ta nxjerrë Kurthin nga manipulimi i seancave çdo 48 orë e që nuk kanë afat kufizues ligjorë kur përfundojnë prandaj, duke e përfunduar konstituimin e Kuvendit krijohen kushtet ligjore që Kurthi të futet në afate kohore pa mundësi t'i shtyjë deri në pafundësi. Me funksionalizimin e Kuvendit krijohen kushtet që Kurthi të dërgohet në opozitë ose ta arnojë një qeveri me 61 deputetë, me jetëgjatësi të fluturës. Pastaj, edhe nëse sigurohen 61 vota për funksionalizim të Kuvendit, përsëri pozita do të ketë vetëm 57 deputetë, do të mbetej dhe varej nga mëshira e opozitës. As Lenka Haxhiu e as Albin Kurthi nuk mund të provokojnë zgjedhjet e parakohshme, pa vullnetin dhe pajtimin e opozitës. Vetëm nëse ka një marrëveshje midis pozitës dhe opozitës që pas konstituimit të Kuvendit, ai të shpërndahet dhe të shkohet në zgjedhje, mund të bëhet ndonëse askush ndonëse fjalët i kanë babush, nuk janë të interesuar për zgjedhje të reja.
Kuvendi duhet të debllokohet, ky do të duhej të ishte vendimi unanimisht i deklaruar nga opozita, nuk ka mundësi tjera! Çdo zvarritje i përshtatet Kurthit, ai e luan këtë lojë.
Opozita duhet të funksionalizojë Kuvendin për të hetuar dhe shkarkuar kriminelët e ZRrE-së, për të hetuar shpenzimin e 700 milionë eurove për blerje të rrymës, për të hetuar përshtatjen e kushteve të tenderëve për kompanitë greke të Micotakisit, pa asnjë përvojë e që ia rruan Kosovës qindra milionë euro për riparim të kaldajave të termocentralit Kosova A , B dhe C. Duhet të hetohet edhe vrasësi i Brezovicës nga Shqipëria që në ortakëri me filojugosllavin, Jeton Qurroi bënë ekocid në Brezovicë. I njëjti, me vetëm dy punëtorë (Mic Sokola) i përlau mbi 160 milionë euro Kosovës duke tregtuar me rrymë sipas parimit të "bacës Martin": "shitë lirë, blejë shtrenjtë…". Qytetarët po varfërohen krejt dhe drejt nga qeverisja e paaftë që donë ta vazhdojë keqbërjen përmes bllokimit të Kuvendit. Opozita duhet ta pengojë këtë. Opozita nuk e ka asnjë detyrim ta votojë propozimin e pozitës për themelim të Kuvendit por se është interes publik të mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës njëherësh votues të tyre.
Mos u futni në labirintin e Kurthit, dilni në ballë të proceseve dhe merrni përgjegjësi. Kosova po shndërrohet në një vend ku shpresa nuk vdes e fundit, por e para. Zhbllokojeni procesin që po përpiqet të bllokohet nga Kurthi dhe ministrat që, përveç pagave të larta, në emër të mëditjeve i marrin nga 16 mijë euro në vit.
Të jesh apo të mos jesh, është çështje tani… zhbllokimi i bllokimit të procesit nga antikombëtarët dhe keqbërësit!

---

ndërkombëtare, partia fituese do t'i vendoste tre emra të pranueshëm dhe prej tyre të zgjidhej ai i cili do të merrte vota më shumë. Kështu do të ishte dashur të ndodhë ose do të bëheshin konsultimet prej një listë prej tre emrash, apo pesë emrash, apo dy emrash.

*Çfarë rreziku ka për Kosovën, institucionalisht dhe politikisht, nëse kjo situatë vazhdon?*
**Rashiti:** Shiko, Kosova është tanimë e dërrmuar nga krizat politike, nga marrëdhëniet jo të mira me faktorët ndërkombëtarë, nga mungesa e zhvillimit, nga njëfarë forme stagnimi institucional dhe zhvillimor. Nga krizat e vazhdueshme, nga tensionet me Serbinë, nga mungesa e dialogut me BE dhe nga sanksionet e BE-së. Dhe nga zhvillimet e shpejta ndërkombëtare që po rrezikojnë qëndrueshmërinë edhe vendeve të tjera, jo vetëm të Kosovës. Do të duhej të kishte një veprim tërësisht ndryshe politik institucional të Kosovës, që të jetë Kosova shumë e përgatitur për situata të reja, po ja që skena politike po vazhdon me avazin e vjetër të hipokrizisë dhe është vështirë të kuptohet saktë çfarë janë qëllimet e subjekteve të caktuara politike.

*Si e shihni zgjidhjen e kësaj situate, a duhet të përfshihet edhe Presidenca, a duhet ndonjë ndërmjetësues?*
**Rashiti:** Jo, nuk ka nevojë. Subjektet politike parlamentare duhet ta gjejnë mënyrën për konstituimin e Kuvendit, pastaj formula dhe procesi për formimin e Qeverisë është shumë e qartë. Zgjidhja më e mirë është që Lëvizja Vetëvendosje të dalë me tre emra për kryetar të Kuvendit dhe njëri prej tyre domosdo do të duhej të votohej nga opozita.

*A ekziston mundësia reale për zgjedhjet e reja në këtë rast? A do të ishin ato zgjidhje apo thellim i ndarjeve politike?*
**Rashiti:** Do ta dërrmonim Kosovën zgjedhjet e reja, duke pasur parasysh se do të kemi zgjedhje edhe në tetor, zgjedhje lokale. Paradoksi më i madh është që në këtë fazë të formimit të institucioneve, çdokush flet që këto institucione do të kenë mandat më pak se një vit dhe nëse do të kemi zgjedhje të reja në muajt në vijim, do ta dërrmonim Republikën, do t'i dërrmonim institucionet. Do të kishte mungesë ose rënie e efektshmërisë së institucioneve, ekonomisë edhe e kështu me radhë dhe natyrisht do të ulej tej mase besimi publik, besimi i qytetarëve në institucione, përfshirë edhe pjesëmarrjen në zgjedhje.

*I përmendët qytetarët, a ndikon ky ngërç në besimin e qytetarëve në institucionet demokratike, a mund të ketë pasoja?*
**Rashiti:** Ka rënie enorme të besimit në institucione, por duke polarizuar skenën politike ka një stabilitet ose një konsolidim të pikëpamjeve qytetare në raport me njërin subjekt apo me tjetrin. Dhe në njëfarë forme, polarizimi po i shërben për të ruajtur subjekte politike, për ta ruajtur mbështetjen e verbër në njëfarë forme për to, por natyrisht kjo nuk përkthehet në mbështetje institucionale dhe do të përkthehet në degradim të institucioneve, sepse liderët e subjekteve janë vënë në epiqendër të kësaj mbështetjeje dhe të këtij narracioni publik.

*Si i percepton bashkësia ndërkombëtare këto zhvillime, a mund të pritet ndonjë presion apo ndërhyrje diplomatike për zhbllokimin e situatës?*
**Rashiti:** Jo, faktori ndërkombëtar, ShBA-ja dhe BE-ja, janë shumë të zëna me agjenda të tjera ndërkombëtare dhe nuk e besoj që do të kemi ndonjë angazhim të ndonjë qeverie apo faktori ndërkombëtar në Kosovën, përveç nëse ndodh ndonjë krizë serioze e sigurisë. Por, përndryshe nuk shoh që do të kemi ndonjë intervenim direkt në procesin e formimit, konstituimit të institucioneve.

*Sa mund ta dëmtojë kjo krizë e brendshme Kosovën ndërkombëtarisht?*
**Rashiti:** Kosova është e dëmtuar në rrafshin ndërkombëtar edhe ashtu, dhe besimi në Kosovën dhe në aftësinë e institucioneve për ta angazhuar ndonjë agjendë mirëfilli ndërkombëtare, është shumë e mangët. Kosova humbi prapë shansin e anëtarësimit në Këshillit të Evropës.
Kosova nuk po gjen rrugën që të dialogojë me BE-në për heqjen e masave, nuk po bën veprime për t'i bindur ata që të heqin masat. Kosova nuk ka asnjë agjendë reale ndërkombëtare në këtë kohë dhe të gjitha janë në një pritje të një formimi të një qeverie stabile. Edhe ashtu faktori ndërkombëtar nuk do t'i besojë asnjë qeverie minore siç është, duke pas parasysh, siç e thashë, të gjithë presin se ciklet zgjedhore do të pengojnë formimin e ndonjë politike të mirëfilltë dhe afatshkurtër apo afatgjatë të Kosovës.



# RASHITI: PARTITË POLITIKE JANË TË OBLIGUARA TA GJEJNË KONSENSUSIN PËR FORMIMIN DHE KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, Naim Rashiti, ka thënë se ngërçi institucional që ka përfshirë Kuvendin e Kosovës pas zgjedhjeve të fundit, po zgjatet në mënyrë të rrezikshme, duke thelluar krizën politike dhe duke e vendosur vendin në një rrugë të pasigurisë kushtetuese. Ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se partitë politike janë të obliguara ta gjejnë konsensusin për formimin dhe konstituimin e Kuvendit. "Zgjidhja më e mirë është që Lëvizja Vetëvendosje të dalë me tre emra për kryetar të Kuvendit dhe një prej tyre domosdo do të duhej të votohej nga opozita", ka thënë Rashiti

PRISHTINË, 28 PRILL - Për të shtatën herë me radhë deputetët nuk kanë arritur ta konstituojnë Kuvendin, duke e vënë në pah jo vetëm mungesën e konsensusit politik, por edhe mungesën e vullnetit për t'i respektuar përgjegjësitë institucionale që dalin nga rezultati i zgjedhjeve. Kështu thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë.

Ai thotë se ngërçi institucional që ka përfshirë Kuvendin e Kosovës pas zgjedhjeve të fundit po zgjatet në mënyrë të rrezikshme, duke thelluar krizën politike dhe duke e vendosur vendin në një rrugë të pasigurisë kushtetuese. "Asgjë e re çka ka ndodh në të kaluarën, as 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë, demokracia në Kosovë nuk i nxjerr mësimet, nuk maturohet, vazhdon me sjellje të njëjta, përkundër një procesi zgjedhor dhe një dite të votimit shumë të mirë, përkundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe elaborimeve të sakta të Gjykatës Kushtetuese. Subjektet politike dhe eksponentët politikë i përdorin manovrat për të parandaluar konstituimin e Kuvendit dhe besoj që do të jemi në një situatë, e cila do të vazhdojë me shumë paqartësi, derisa ndoshta do të kemi një proces të ri të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë duhet të kujdesen edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Siç edhe në të kaluarën, 2014-2017, përgjegjësia për konstituimin e Kuvendit është e partisë fituese, edhe atëherë edhe tani, partia fituese ka obligim të gjejë një kandidat të pranueshëm për më shumë deputetë, për shkak se kryetari i Kuvendit ka një rol përfaqësues të Kuvendit dhe ka një rol tjetër i cili është edhe ushtruesi i detyrës së presidentit, që domosdoshmërish duhet të jetë një figurë sa më konsensuale. Edhe qeveritë e kaluara, në të kaluarën nuk e kanë bërë, por kemi menduar që tani, pas shumë viteve, politika sadopak është maturuar dhe do të duhej ta bënte. Derisa nuk ndodh kjo, apo një marrëveshje e partisë fituese me partitë e vogla, nuk do të kemi konstituim të Kuvendit", ka theksuar Rashiti.

Ai është pyetur nëse partitë politike do të mund të arrijnë ndonjë marrëveshje për ta zgjidhur këtë çështje? "Kështu e kanë me mandat dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, që partitë politike janë të obliguara të gjejnë konsensusin për formimin dhe konstituimin e Kuvendit. [Tash] nuk po e bëjnë dhe nuk do ta bëjnë dhe gjithmonë, si në të kaluarën, partia fituese përgjegjëse dhe bartëse e këtij procesit e pengon këtë proces deri në sigurimin e votave për qeverinë".

*A duhet të insistojë Lëvizja Vetëvendosje me kandidaten e saj, kur nuk i ka votat e nevojshme?*

**Rashiti:** Natyrisht që jo, partia fituese do të duhej ta ketë një kandidat, i cili siguron mbështetje më gjerë. Natyrisht që të jetë nga propozimi i tyre, rangu i tyre dhe të jetë një kandidat, i cili ofron përfaqësim më të gjerë të Kuvendit. Po kështu kanë bërë partitë në të kaluarën, kështu ka ndodhur në vitet 2014 dhe 2017, dhe kështu e njëjta logjikë po vazhdon edhe me Lëvizjen Vetëvendosje si fitues i këtyre zgjedhje.

*A është problemi vetëm te emri i propozuar për kryetar të Kuvendit apo, sipas jush, bëhet fjalë edhe për diçka tjetër në këtë situatë?*

**Rashiti:** Besoj që me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, gjithkush e di, çdo subjekt e di radhën dhe përgjegjësinë kushtetuese për formimin e institucioneve. Të gjitha subjektet e dinë përgjegjësinë dhe të drejtën ekskluzive të Lëvizjes Vetëvendosje si partisë fituese. Prandaj, nuk e shoh që partitë tjera opozitare, në parim mund të mos i votojnë kandidatët e partisë fituese, por deri atëherë është përgjegjësia e partisë fituese të propozojë kandidatë të cilët janë më të pranueshëm për opozitë, nëse ju duhet vota e tyre. Dhe këtë nuk e kemi dëshmuar. Jam i bindur që, nëse ka kandidatë të tjerë, partitë opozitare do t'i votonin ata ose në rastin se jo, atëherë do të ekspozoheshin se ata janë bllokues të konstituimit të Kuvendit. Në praktikat

## Ndërron jetë ushtari i Brigadës 121 të UÇK-së, Naser Shala, i njohur si “Ftyra”



**Prishtinë, 28 prill** - Naser Shala ishte një ndër ushtarët më të hershëm të Brigadës 121 “Ismet Jashari - Kumanova”, i organizuar në UÇK me Mujë Krasniqin e Rexhep Selimin, bashkëluftuar i komandant “Kumanovës”, Fatmir Limajt, Haxhi Shalës, Ajet Kastratit e shumë luftëtarëve dhe dëshmorëve të kombit.

Naseri si epror i Brigadës kreu shumë detyra të rëndësishme në organizimin ushtarak të njësive të UÇK-së, me devotshmëri të lartë e heroizëm të pashoq qëndronte me shokët luftëtarë nëpër vijat e para të frontit. Njihej me nofkën e luftës “Ftyra”. Ishte shumë i dashur me shokët dhe besnik në çdo rrethanë luftarake të kohës.

# E VËRTETA NUK GJYKOHET

Shkruan:
Hisen BERISHA



Tashmë jemi dëshmitarë të një prej padrejtësive më të mëdha që po i ndodh popullit shqiptar në epokën moderne - gjykimi i padrejtë në Hagë.

Ky proces nuk është më vetëm një çështje ligjore, por është një përpjekje për të përmbysur të vërtetën historike dhe për ta barazuar viktimën me agresorin. Kjo nuk po bëhet vetëm përmes aktakuzave të fabrikuara dhe ndërtimit të një narrative të falsifikuar, por përmes një strategjie të qëllimshme dhe të rrezikshme, prokuroria ka përdorur dëshmi nga burime tendencioze dhe të motivuara armiqësisht ndaj Kosovës, dëshmitarë të manipuluar, të pavërtetë dhe shpesh edhe me probleme mendore. Sido qoftë, organi i akuzës në Hagë, e përmbylli sagën e dëgjimit të dëshmitarëve dhe dëshmive të tyre për mbështetje të akuzave të pretenduara nga Prokuroria në Hagë. Tani është radha e Trupit Gjykues të marrë vendimin dhe e Trupës së Mbrojtësve që t’i kundërshtojnë me argumente pretendimet e akuzës ndaj palëve.

Për më tepër, vetë figura qendrore e organit të akuzës, prokurori Jack Smith, është një emër që bart mbi vete një histori të gjatë kontestimesh dhe skandalesh në sistemin e drejtësisë ndërkombëtare dhe amerikane.

Është ironi e rëndë që një figurë e tillë të ndërtojë aktakuza ndaj një lufte çlirimtare, ndërsa ai vetë është nën hijen e akuzave për veprime të njëanshme, të motivuara politikisht dhe me integritet profesional të dyshimtë të faktuara nga Departamenti i Drejtësisë Amerikane.

Si mund të quhet drejtësi një proces që ndërtohet mbi dëshmi të manipuluara dhe udhëhiqet nga një njeri që vetë përfaqëson krizën e drejtësisë?

Kjo nuk është vetëm padrejtësi ndaj individëve që janë në bankën e të akuzuarve, por është sulm ndaj gjithë sakrificës sonë si popull, ndaj idealit të lirisë, ndaj të drejtës për vetëmbrojtje kundër shtypjes dhe gjenocidit.

Përballë kësaj padrejtësie në emër të drejtësisë, duhet të jemi të përgatitur, duhet të jemi në mbështetje të Trupës Mbrojtëse në Hagë, populli në Kosovë në tërësinë e tij institucionale.

Duhet të flasim me një zë, të veprojmë me një vullnet, dhe të qëndrojmë me një bindje të palëkundur: se e vërteta nuk poshtërohet, dhe drejtësia nuk blihet.

Kjo situatë padrejtësie, duhet të vërë në veprim institucional ligjor e kushtetues shtetin; kërkon intensifikim të veprimit diplomatik me aleatët; populli që të bëjë presionin në rrugë e sheshe për të mbrojtur identitetin historik nga padrejtësia e një drejtësie që i është mbivendosur Kuvendit e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Për këtë kauzë do ta kemi dhe duhet ta kërkojmë edhe mbështetjen e popujve që janë përballur me Hagën pas luftërave çlirimtare, si Kroacia e cila më herët ofroj gatishmërinë për ti pranuar të mbajturit në Dhomat Speciale në Hagë që të mbrohen në liri në një shtet të tretë, në këtë rast në Kroaci.

Për ta hequr njëherë e mirë mjegullnajën që ka krijuar ky mekanizëm i komprometuar në Hagë, duhet të kërkojmë publikimin e të gjitha dëshmive të dhëna në këtë proces, fakteve mbi të cilat po mbështeten akuza në proces, në mënyrë që opinioni të kuptojë të vërtetën e plotë dhe të shohë me sytë e vet manipulimin e qëllimshëm që po ndodh.

Secilit dëshmitar që ka njollosur luftën e UÇK-së me dëshmi të rreme, duhet t’i hiqet menjëherë statusi i dëshmitarit të mbrojtur dhe të ndiqet penalisht për mashtrim dhe dëshmi të rreme, siç e kërkon çdo standard elementar i drejtësisë ndërkombëtare.

Kjo nuk është vetëm çështje ligjore por është një çështje e nderit kombëtar.

Historia nuk do të na falë nëse heshtim sot.

E vërteta jonë kërkon zë.

Liria jonë kërkon mbrojtje.

Nesër është vonë!

# REGJISTRIMI I FAKTEVE TË GJENDJES CIVILE, MPB-ja NJOFTON SE AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM ËSHTË MË 30 PRILL



**Prishtinë, 28 prill** - Ministria e Punëve të Brendshme i ka njoftuar qytetarët se ka mbetur pak kohë deri në përfundimin e afatit për aplikim për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile, sipas vendimit të ministrit të Punëve të Brendshme, me nr. 0616/2024 të datës 21 nëntor 2024. Në një komunikatë për medie, Ministria u ka bërë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë mundësinë e regjistrimit të fakteve deri më 30 prill 2025.

Pas këtij afati faktet e gjendjes civile, përkatësisht lindjet, martesat dhe vdekjet, të cilat janë regjistruar në strukturat jolegale serbe nga data 10 qershor 1999 deri më 1 shkurt 2025, nuk do të mund të regjistrohen më në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile të Republikës së Kosovës.

“Ftojmë qytetarët që të shfrytëzojnë të drejtën për regjistrim të fakteve sipas vendimit nr. 0616/2024 të datës 21.11.2024 deri me datë 30 prill 2025. Pas kësaj date, faktet që janë regjistruar në strukturat jolegale serbe nuk do të mund të regjistrohen në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile”, theksohet në njoftimin e Ministrisë.

Përveç kësaj, MPB i informon qytetarët se për rastet e lindjeve dhe vdekjeve që kanë ndodhur pas 1 shkurtit 2025 në territorin e Republikës së Kosovës, ata që nuk mund të ofrojnë një certifikatë ose dokument si dëshmi mund ta parashtrojnë kërkesën për regjistrim të mëvonshëm përmes deklarimit, pranë Zyrave të Gjendjes Civile në komunat përkatëse. “Trajtimi i kërkesave, kriteret dhe procedura do të zhvillohet në pajtim me legjislacionin e gjendjes civile. Qytetarët mund të marrin informatat në Zyrën e Gjendjes Civile ku do të parashtrojnë kërkesën, lidhur me dokumentet që duhet të dorëzojnë dhe kriteret që duhet ti plotësojnë”, thuhet në komunikatën e Ministrisë.

Deri tani vendimi është zbatuar me sukses dhe gjatë periudhës 01.02.2025 deri më 25.04.2025 janë realizuar gjithsej 4 330 regjistrime, përfshirë 2 159 lindje, 1 108 martesa dhe 1 063 vdekje.

Ministria e Punëve të Brendshme ka theksuar se po vazhdon t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ta siguruar zbatimin e plotë të Vendimit, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për qytetarët e Kosovës.

# KOSOVA LËSHON FLETARRESTIM NDAJ RADOÇIQIT PËR KRIME LUFTE



**Prishtinë, 28 prill** - Gjykata Themelore e Prishtinës ka lëshuar fletarrestim ndaj Millan Radoiçiqit dhe 19 serbëve të tjerë, të dyshuar për veprën penale "krime lufte kundër popullatës civile". Sipas dokumentit që mban datën e 15 prillit, të publikuar nga "Reporteri.net", Radoiçiq - ish-nënkryetar i partisë së serbëve në Kosovë, Lista Serbe - akuzohet se ishte pjesë e një grupi serbësh që vranë 106 civilë shqiptarë, trupat e të cilëve më pas u gjetën në një varrezë masive në Serbi.

Nga Prokuroria Speciale e Kosovës kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore për lëshimin e fletarrestimeve. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ne kërkesë ka cituar se me datë 18.03.2025 ka nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj të pandehurve për shkak të dyshimit të arsyeshëm se në periudhën kohore 1998-1999, në vendin e quajtur 'Ura e Taliqit' në Gjakovë nga data 7 maj e deri më date 10 maj te vitit 1999, pjesëtaret e forcave ushtarake dhe policor serbe të uniformuar, në mesin e tyre edhe të pandehurit e lartcekur filluan të hynin shtëpi për shtëpi, ku me forcë dhe kanosje i nxorën nga shtëpitë të gjithë personat që ishin prezentë, duke i ndarë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe me pas i vranë gjithsej 106 civilë të nacionalitetit shqiptar dhe pas luftës trupat e tyre u gjetën në një varrezë masive në Batajnice të Serbisë", thuhet në arsyetimin e fletarrestimit.

Po në dokument thuhet se ky grup i personave nga 7 maji i vitit 1999 deri më 10 maj të po atij viti kishte arrestuar dhe burgosur më shumë se 300 civilë shqiptarë, të cilët "u mbajtën në burgje të improvizuara, ku nuk kishin trajtim human duke iu munduar gjërat elementare, ushqimi i rregullt, higjiena dhe kujdesi mjekësor dhe më pas një pjesë e madhe e këtyre të burgosurve ishin dërguar në burgje të ndryshme të Kosovës". Në fund, sipas Gjykatës Themelore, këta persona u liruan pas qershorit të vitit 1999, me ndihmën e organizatave ndërkombëtare.

Për të gjithë të pandehurit që është lëshuar fletarrestim, autoritetet e Kosovës nuk e dinë adresën e tyre. Ndërkaq, në mesin e tyre është edhe Llazar Drashkoviq, ndaj të cilit veçse ka një urdhërarrest aktiv ndërkombëtar lidhur me masakrën e Mejës.

Radoiçiqi veçse kërkohet nga autoritetet e Kosovës për sulmin e armatosur në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023. Ai e mori përgjegjësinë për këtë sulm, ku u vra një polic i Kosovës. Ai besohet se gjendet i lirë në Serbi.

Kosova e ka cilësuar atë sulm si terrorist dhe e ka akuzuar Serbinë se ka gisht në të. Beogradi mohon çdo përfshirje.

Në Kosovë për sulmin në Banjskë është ngritur edhe një aktakuzë - ku përfshihet edhe Radoiçiqi - dhe ka nisur gjykimi ndaj tre të pandehurve për këtë rast, që gjenden në Kosovë. Gjykata Themelore e Prishtinës ka refuzuar ankesën që ndaj të pandehurve të tjerë për rastin Banjska të zhvillohet gjykim në mungesë.

Megjithatë, në Kosovë zhvillohen gjykime në mungesë për raste të krimeve të luftës. Këto lloj gjykimesh, sipas sistemit të drejtësisë në Kosovë, mund të zhvillohen vetëm me kusht që prokuroria dhe gjykata t'i kenë shteruar të gjitha mjetet për ta siguruar praninë e të akuzuarit.

Krimet e luftës në Kosovë deri më 2008 janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX).

Dhjetë vjet më vonë EULEX-i ia dorëzoi lëndët Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe gjykatave vendore. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

# PËRJASHTIMI I KATËR KOMUNAVE NË VERI NGA RRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË, CENIM I BARAZISË DHE I SOVRANITETIT TË KOSOVËS



**Prishtinë, 28 prill** - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin lidhur me vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe të Qeverisë së Kosovës për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për 16 %, duke përjashtuar nga ky vendim katër komunat në veri të Kosovës të banuara kryesisht me qytetarë serbë.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se ky veprim përbën shkelje të rëndë të parimeve të barazisë dhe trajtimit të barabartë të qytetarëve dhe konsumatorëve në Republikën e Kosovës. "Me këtë vendim jo vetëm që cenohet e drejta e konsumatorit shqiptar, por krijohet edhe një ndarje etnike dhe diskriminuese e papranueshme. AKB vlerëson se një praktikë e tillë minon sovranitetin energjetik të Republikës së Kosovës në pjesën veriore të vendit dhe dëmton parimin e barazisë para ligjit. Kjo qasje jo vetëm që cenon drejtësinë dhe interesin e bizneseve dhe qytetarëve të tjerë të vendit por, njëkohësisht, dobëson besimin në institucionet shtetërore ne Veriu e Kosovës. Ne kërkojmë që ZRRE dhe Qeveria e Kosovës t'i trajtojnë të gjithë qytetarët dhe bizneset në mënyrë të barabartë, pa diskriminim etnik", ka thënë ai, duke shtuar se duhet të rikthehet urgjentisht sovraniteti energjetik në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

"Të respektohen dhe mbrohen të drejtat e konsumatorëve në mënyrë të paanshme dhe transparente. Aleanca Kosovare e Bizneseve mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e interesave të biznesit dhe konsumatorëve në Kosovë dhe do t'i përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për ta kundërshtuar këtë padrejtësi", ka thënë Agim Shahini, kryetar i AKB-së.

## Nga 1 maji pa kontrolle në kufirin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

**Prishtinë, 28 prill** - Nga 1 maji do të rikthehet në funksion marrëveshja e lëvizjes së lirë në mes të pikës kufitare të Vërmicës dhe Morinit, e cila kishte pushuar së funksionuari nga 1 marsi. Si rrjedhojë e rikthimit në funksion të kësaj marrëveshjeje, nuk do të ketë më kontrolle në kufirin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Në pikën kufitare të Morinit gjatë fundjavës pati fluks të shtuar të udhëtarëve.

Të dhënat e fundit nga Dogana e Morinës tregojnë se deri në mesditën e së shtunës kanë hyrë në territorin e Shqipërisë 4 291 shtetas dhe 2 036 mjete, raporton RTSh, ndërsa në dalje janë regjistruar 3 834 shtetas dhe 1 967 mjete.



# POSTA E KOSOVËS HAP ZYRË TË RE NË LEPOSAVIQ

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Leposaviq, 28 prill** - Në qendër të qytetit të komunës së Leposaviqit të hënën është hapur pika e re, e katërta në këtë komunë, e Postës së Kosovës, në objektin e rikthyer nën menaxhim të Postës së Kosovës. Të pranishëm në këtë përurim ishin kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kryetari i komunës së Leposaviqit, Lulzim Hetemi, kryesuesi i Bordit të Postës së Kosovës, Gëzim Paci dhe kryeshefja e Postës së Kosovës, Nora Rraci.

Kryeministri Kurti përgëzoi dhe falënderoi Postën, Ministrinë e Ekonomisë dhe Komunën e Leposaviqit për punën. Ai tha se hapja e zyrës së re në pronën e rikthyer është bashkëdyzim i ligjshmërisë dhe cilësisë. "Ata operatorët e palicencuar që kanë funksionuar më herët janë mbyllur dhe tash e kemi Postën e Kosovës ku, përveç dërgesave të zakonshme të postës, mund të pranohen edhe mjete financiare në euro për qytetarët e Leposaviqit. Ky është një lajm i mirë edhe për banorët e komunës, por edhe për shërbimin postar publik të Republikës së Kosovës", u shpreh kryeministri.

Më tej, ai theksoi se dikur Posta e Kosovës ka operuar me humbje, kurse tash me kryeshefen e re, Nora Rracin, ajo operon me fitim dhe, përveç kësaj, ka shtrirje anekënd komunave të Kosovës dhe përbrenda komunave, përfshirë edhe në zonat të cilat janë më larg qyteteve dhe qytezave. "Posta e Kosovës nuk e shikon se ku ka fitim që të ketë zyrë, por ka ku qytetarë që të ketë shërbim", tha kryeministri.

Kryetari i komunës, Lulzim Hetemi, falënderoi dhe përgëzoi qeverinë dhe postën për përurimin e sotëm dhe e



ftoi këtë të fundit të hapë edhe pika të tjera në komunën që ai drejton.

Ndërkaq kryeshefja e Postës së Kosovës, Nora Rraci, foli për planet e ndërmarrjes që udhëheq, për të qenë sa më të pranishëm aty ku qytetarët kanë nevojë për shërbimet e operatorit publik, por edhe për rezultatet e zgjerimit të rrjetit të pikave të postës. Ajo tha se "nëse flasim në krahasim me vitin e kaluar, kemi pasur një rritje prej 11 % të numrin të zyrave postare gjithandej Kosovës. Nëse flasim për katër komunat veriore të Kosovës, para dy vjetëve kemi pasur vetëm dy zyra në pikat kufitare, ndërsa po festojmë pikën 13-të, që besoj se është një rezultat shumë i madh duke qenë se e kemi arritur brenda dy vjetëve".

Ministrja Rizvanolli, e cila u shpreh e lumtur me hapjen e kësaj pike sot, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës, do të vazhdojë ta mbështesë Postën në zgjerimin e rrjetit të saj dhe avancimin e shërbimeve që ofron.

Posta e Kosovës, me mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, po zbaton programin e zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të saj. Si rezultat janë arritur 157 zyra postare aktive në gjithë Kosovën, duke shënuar një rritje prej 11 %; Në katër komunat veriore operojnë tashmë 13 zyra postare; Është investuar në mjete të reja transporti, infrastrukturë IT dhe shërbime të reja postare dhe financiare.

Posta e Kosovës ofron shërbime moderne për qytetarët, përfshirë transferime ndërkombëtare të parave, shpërndarjen e dokumenteve shtetërore dhe mbështetjen e zhvillimit të e-commerce.

# VENDIMI PËR RRITJEN E TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NUK DO T'I PËRFSHIJË KATËR KOMUNAT VERIORE

**Prishtinë, 28 prill** - Vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike është padyshim një nga temat më aktuale në vend. Të pakënaqur me këtë vendim janë qytetarët dhe bizneset, pasi nga 1 maji do të paguajnë shumë më shtrenjtë për rrymën e shpenzuar, 16.1 për qind - të gjitha kategoritë e konsumatorëve, raporton "KosovaPress". E derisa ata do të paguajnë më shumë për rrymë, kjo nuk vlen edhe për serbët në veri të vendit, të cilët nuk preken nga vendimi i ZRRE-së.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka thënë për "KosovaPress" se vendimi për rritjen e tarifave të energjisë elektrike 16.1 për qind nuk do t'i përfshijë katër komunat veriore të vendit.




Në një përgjigje me shkrim të ZRRE-së, tarifat e miratuara nga Bordi i këtij institucioni do të hyjnë në fuqi më 1 qershor 2025 dhe do të zbatohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal në të gjithë territorin ku ai operon. Megjithatë, sipas ZRRE-së, komunat veriore - të cilat aktualisht furnizohen nga kompania "Elektrosever" - nuk përfshihen në këtë vendim pasi, siç thuhet nga ZRRE-ja, "Elektrosever" operon jashtë sistemit të Furnizuesit me Shërbim Universal dhe marrëdhëniet tarifore atje janë të ndryshme. "Tarifat e miratuara nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) zbatohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal duke filluar nga data 1 qershor 2025 në gjithë territorin ku ai operon. Nëse pyetja ka të bëjë me katër komunat veriore të vendit të cilat aktualisht furnizohen nga 'Elektrosever', atëherë këto tarifa nuk zbatohen në atë pjesë të territorit, për shkak se 'Elektrosever'-i operon jashtë sistemit të Furnizuesit me Shërbim Universal dhe marrëdhëniet tarifore janë të ndryshme" thuhet në përgjigjen me shkrim nga ZRRE-ja.

Për gati 25 vjet banorët në katër komunat veriore të vendit nuk kanë paguar për energjinë elektrike të shpenzuar. Faturimi në këtë pjesë ka filluar në shkurt të vitit 2024, por pjesa më e madhe e banorëve vazhdojnë të mos e paguajnë.

Shkalla e pagesës që nga shkurti i vitit 2024 e deri në dhjetor të po këtij viti për Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok mësohet të jetë jo më pak se 20 për qind.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë më 11 prill bëri me dije se rritja e tarifave për të gjitha kategoritë e konsumatorëve bazuar në të Hyrat e Lejuara Maksimale është 16.1 për qind.

Qytetarët e Kosovës nga muaji maj do të paguajnë 16.1 për qind më shtrenjtë për energjinë elektrike. Kështu kishte thënë kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu. Shtrenjtimi i energjisë elektrike ka shkaktuar reagime të shumta nga bizneset, subjektet politike dhe qytetarët.

# BANKA BOTËRORE PARASHIKON RËNIE EKONOMIKE NË KOSOVË DHE NË SHQIPËRI

**Prishtinë, 28 prill** - Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor parashikohet të ngadalësohet me ritëm të moderuar në vitin 2025 për shkak të kërkesës së jashtme më të ulët si dhe pasigurisë ekonomike të krijuar si rezultat i ndryshimeve që po ndodhin në politikat tregtare globale, të cilat mund të ndikojnë në besimin e bizneseve dhe të konsumatorëve, thuhet në Raportin e Rregullt Ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, të publikuar të hënën.

Banka Botërore parashikon se norma e përbashkët e rritjes ekonomike e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë do të arrijë në 3.2 % në vitin 2025, që paraqet një ndryshim me 0.5 pikë përqindje më pak nga parashikimi i mëparshëm. Rritja ekonomike parashikohet të përshpejtohet në 3.5 % në vitin 2026. "Ne po vërejmë disa tendenca pozitive ekonomike në Ballkanin Perëndimor, të cilat nxjerrin në pah qëndrueshmërinë e rajonit dhe mund ta mbështesin rritjen solide të tij. Inflacioni më i ulët dhe rritja e pagave mbështesin konsumin, ndërsa investimet publike po rriten", thotë Xiaoqing Yu, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. "Nga ana tjetër, po vërejmë rritje të pasigurisë së brendshme në disa nga ekonomitë e Ballkanit




Perëndimor. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Bashkimin Evropian dhe pasiguritë në rritje në tregtinë globale gjithashtu mund të ndikojnë negativisht në perspektivën e rritjes ekonomike të rajonit".

Pasiguria në tregtinë globale ka gjasë ta prekë Ballkanin Perëndimor, kryesisht si rrjedhojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në zonën e euros. Ky ngadalësim mund ta zvogëlojë tregtinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe investimet dhe dërgesat.

Raporti sugjeron se strategjitë më efikase për ruajtjen e stabilitetit ekonomik gjatë periudhave të pasigurisë ekonomike janë diversifikimi i burimeve të rritjes dhe rinovimi i agjendës së reformave strukturore. Masat kryesore përfshijnë eliminimin e barrierave në tregun e punës - përfshirë ato që prekin gratë - forcimin e integrimit ekonomik rajonal, përmirësimin e standardeve të qeverisjes dhe rritjen e konkurrencës në treg për ta nxitur produktivitetin dhe mbështetur rritjen ekonomike afatgjatë, thuhet në komunikatën për medie.

# MBI BUDALLALLËKUN: NJË PARALAJMËRIM

Jean-François Marmion*



"Arsyeja e shëndoshë është gjëja më e baraz-shpërndarë në botë," shkruante Dekarti. Po budallallëku?
Qoftë duke pikuar a duke rrjedhur, duke shpërthyer apo duke u derdhur, ai është kudo. Pa kufij. Nganjëherë shfaqet si një lëpirje e lehtë, pothuajse e durueshme; herë të tjera si një moçal i ndenjur dhe neveritës. E në raste të tjera, si një tërmet, një stuhi apo një valë gjigante që përpin gjithçka në rrugën e vet, duke shkatërruar, duke shkelur e ndotur gjithçka. Pavarësisht formës që merr, budallallëku na spërkat të gjithëve. Thuhet madje se burimi i tij jemi vetë ne.

## Pesha e padurueshme e të qenit

Çdo njeri sheh, dëgjon dhe lexon marrëzira, çdo ditë. Në të njëjtën kohë, secili prej nesh është fajtor për prodhimin e tyre, se i mendon, i përtyp në mendje dhe i shqipton me zë të lartë. Të gjithë ne bëhemi budallenj herë pas here, duke nxjerrë marrëzira teksa jetojmë përditshmërinë tonë, pa pasoja të vërteta. Ajo që ka rëndësi është të jemi të vetëdijshëm për këtë dhe të ndiejmë keqardhje; sepse të gabosh është njerëzore, dhe të pranosh gabimet është gjysma e faljes së tyre. Gjithmonë do të ketë nga ata që na marrin për budallenj, por ne shumë rrallë e njohim marrëzinë tonë. Përveç murmuritjes së përhershme të marrëzisë që na rrethon ditë pas dite, ekziston, për fat të keq, edhe ulërima e mjeshtërave të budallallëkut, mbretërve të marrëzisë – idiotëve me "I" të madhe.
Këta idiotë, qofshin ata në punë apo në shtëpi, nuk janë rastësorë. Ata të ndjekin, të përndjekin me këmbënguljen e tyre në marrëzi të pashpjegueshme, me arrogancën e tyre të pajustifikuar. Ata përparojnë, firmosin kontrata, dhe do të fshinin me një të rënë të lapsit të gjitha opinionet, emocionet dhe dinjitetin tënd. Ata gërryejnë moralin tënd dhe të bëjnë të dyshosh se në këtë botë të shëmtuar mund të ekzistojë ndonjë lloj drejtësie. Sado që të përpiqesh, nuk arrin të gjesh as edhe një fije lidhjeje njerëzore me ta.
Budallallëku është një premtim i pambajtur, një premtim për inteligjencë dhe besim që idiotët mes nesh e tradhtojnë – janë tradhëtarë të njerëzimit. Këta maskarenj janë si kafshë të trasha – krejtësisht shtazarakë! Mund të kemi dëshirë t'i përkëdhelim, t'i kthejmë në miq, por ata nuk janë në atë nivel – domethënë, në nivelin tonë.
Ata vuajnë nga një sëmundje pa shërim. Dhe, meqenëse refuzojnë të shërohen, të bindur se janë mbretër me një në vendin e të verbërve, tragjikomedia bëhet e plotë. Nuk është çudi që njerëzit janë të magjepsur nga zombit – nga simulimi i ekzistencës që ata mishërojnë, boshllëku i tyre intelektual dhe nevoja e tyre e thellë për të tërhequr poshtë të gjallët, heroikët dhe thjesht njerëzit e ndershëm deri në nivelin e tyre.
Dhe kjo ka logjikë: idiotët, ashtu si zombit, duan të hanë trurin tënd – këta qenie të dështuara nuk të zhgënjejnë kurrë. Gjëja më e keqe tek ata është se ndonjëherë mund të jenë inteligjentë, ose të paktën të shtiren si të tillë. Ata janë mjeshtëra në shndërrimin e kontureve të dijes në hekura burgu dhe do të digjnin me kënaqësi librat – bashkë me autorët e tyre – në emër të ndonjë ideologjie, ose të diçkaje që kanë dëgjuar nga ndonjë i "ditur" (idiot apo jo).

## Pasiguria të çmend, siguria të bën budalla

Budallenjtë të dënojnë menjëherë, pa asnjë mundësi apelimi dhe pa pranuar rrethana lehtësuese, vetëm mbi bazën e dukjes së çastit që arrijnë të shohin përmes bllokadave të tyre të ngushta.
Ata dinë si të nxisin simpatizantët e tyre, si t'i shtyjnë drejt linçimit në emër të virtytit, zakoneve, respektit. Idioti gjuan në tufë dhe mendon në mënyrë kolektive. Siç thotë kënga e Georges Brassens: "Shumësi është i padobishëm për njerëzimin; sa herë që mblidhen më shumë se katër veta, do të gjesh një turmë idiotësh." Ai gjithashtu shton: "Lavdi njeriut që, duke mos pasur ideale madhështore, kënaqet thjesht me faktin që nuk u bëhet pengesë fqinjëve të vet." Për fat të keq, fqinjët tanë nuk na e kthejnë gjithmonë nderin.
I pakënaqur me faktin që të bën të vuash, idioti i bezdisshëm është i kënaqur me veten. I palëkundur. Ai është imun ndaj dyshimit tek vetja dhe i bindur për të drejtën e tij. Idioti i lumtur i shkel të drejtat e tua pa u menduar dy herë. Budallai i merr ato që beson për të vërteta të skalitura në mermer, ndërsa çdo njohuri e vërtetë ndërtohet mbi rërë.
Pasiguria të çmend, siguria të bën budalla; duhet të zgjedhësh në cilin kamp do të bësh pjesë. Maskarai mendon se di më mirë se ti – ai jo vetëm që pretendon të dijë çfarë duhet të mendosh, të ndjesh dhe të bësh me dhjetë gishtat e tu, por di edhe se për kë duhet të votosh. Ai di kush je ti dhe çfarë është më e mira për ty, më mirë sesa ti vetë.
Nëse nuk je dakord me të, ai do të të përçmojë, do të të fyejë dhe do të të sulmojë, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe në mënyrë figurative, për "të mirën tënde". Dhe nëse mund ta bëjë këtë në emër të ndonjë ideali të lartë, nuk do të hezitojë të sulmojë "plehrën" që përfaqëson ekzistenca jote për të, me një ndjenjë të plotë pandëshkueshmërie.
Dhe ja një e vërtetë e hidhur: vetëmbrojtja e justifikuar është një kurth. Nëse përpiqesh të arsyetosh me një idiot ose t'i ndryshosh mendjen, je i humbur. Në momentin që vendos se është detyra jote ta përmirësosh atë, në çastin që mendon se di si duhet të mendojë dhe të veprojë (si ty, sigurisht), loja ka marrë fund. Ja pra: tani je ti budallai — dhe për më tepër je edhe naiv, sepse beson se je në gjendje ta përballosh sfidën.
Edhe më keq: sa më shumë përpiqesh të reformosh një idiot, aq më shumë ai forcohet. Ai kënaqet duke e parë veten si viktimë që shqetëson të tjerët – dhe pikërisht për këtë arsye, ndjehet i bindur se ka të drejtë. Duke e qortuar, ti i jep mundësinë të besojë me bindje të plotë se është një hero i antikonformizmit, dikush që duhet mbrojtur dhe admiruar. Një anëtar i rezistencës… Dridhu përpara madhështisë së këtij mallkimi: nëse përpiqesh të reformosh një idiot, jo vetëm që do të dështosh, por do ta forcosh atë dhe do të inkurajosh imituesit.
Më parë ishte vetëm një budalla: tani janë dy.
Lufta kundër marrëzisë vetëm sa e forcon atë. Sa më shumë ta sulmosh një ogër, aq më shumë shpirtra ai përpin.

## Kalëruesit e Apokalipsit

Në këtë mënyrë, nuk ka asnjë mundësi që budallallëku të humbasë fuqinë e tij. Ai është eksponencial. A po jetojmë sot – më shumë se dje dhe më pak se nesër – në epokën e artë të idiotësisë? Që prej kohërave më të hershme të dokumentuara me shkrim, mendjet më të mëdha të kohërave të tyre e kanë besuar këtë. Ndoshta kishin të drejtë, atëherë.
Nga ana tjetër, ndoshta, si gjithë të tjerët, edhe ata ishin thjesht budallenj të moshuar.
Megjithatë, risia e vërtetë e epokës sonë është se sot mjafton një idiot me një buton të kuq për të shfarosur gjithë budallallëkun – dhe mbarë botën bashkë me të. Një idiot i zgjedhur nga dele që ishin tepër krenare për të zgjedhur kasapin e tyre.
Karakteristika tjetër e madhe e kohës sonë është se, edhe nëse pranojmë se budallallëku nuk ka arritur ende kulmin e tij, dimë se ai nuk ka qenë kurrë më parë kaq i dukshëm, kaq i paturpshëm, kaq i zëshëm dhe kaq i padiskutueshëm. Kjo mjafton për të të bërë të humbasësh shpresën tek bashkëqytetarët. Nga ana tjetër — kush e di? — mund të të frymëzojë t'i drejtohesh filozofisë për ta përballuar situatën, duke qenë se së fundmi është gjithnjë e më e vështirë të mohosh kotësinë e gjithçkaje dhe narcisizmin e gjithkujt, për të mos përmendur marrëzinë e pamjeve dhe mbizotërimin e gjykimeve të cekëta.
Ah, sikur të na shkruante ndonjë Erasmus i dytë një Lavdi Budallallëkut (por në shpërthime me 280 gërma, që të na shpëtonte nga migrena)!
Ah, sikur të na shfaqej një Lukrec i ri për të na sjellë lehtësim dhe ndoshta edhe gëzim — gëzim që do ta shijonim të sigurt në breg, ndërsa anija e budallenjve fundoset, e sabotuar nga vetë pasagjerët e saj, që bërtasin për ndihmë ndërsa mbyten.
Si lakmitarë të pangopur, ne lëpijmë buzët përballë nektarit më të dëshiruar: luftës mes vetë budallenjve, me qimet ngritur dhe egot gati për përplasje. Mendjet e mëdha mendojnë njësoj; mendjet e vogla përplasen.
Ndërsa përpiqesh të mbetesh spektator, jo aktor, në këtë skenë beteje, do të ishte marrëzi të imagjinosh veten më pak të prekshëm nga budallallëku se bashkëkohësit e tu të zymtë, uluritës, të mjerueshëm dhe të trazuar.
Por nëse, rastësisht, do të kishe të drejtë… çfarë fitoreje do të ishte! Është më e mençur të jesh modest; nëse përpiqesh të ngrihesh mbi turmën, nuk do të të falin. Edhe nëse arratisesh nga tufa, do të përfundosh gjithsesi në thertore. Ulëri me ujqërit, blegëri me delet, por kurrë mos ec vetëm; të gjithë do të bërtasin kundër teje.
E vetëkuptueshme: nëse vërtet beson se je më i zgjuar dhe më i admirueshëm se njeriu i zakonshëm, atëherë diagnoza fatale është afër: me shumë mundësi, edhe ti je një bartës i pavetëdijshëm i budallallëkut.
/ Nga libri "Psikologjia e budallallëkut" – Në shqip nga bota.al




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Donjeta Sadiku fiton medaljen e artë në turneun 'Brussels Capital'



Prishtinë, 28 prill - Boksierja e Kosovës Donjeta Sadiku po vazhdon formën e lartë të përfaqësimit në garat ndërkombëtare. Ajo fitoi medaljen e artë në turneun ndërkombëtar "Brusels Capital" të mbajtur në Belgjikë. Sadiku shënoi tri fitore, ndërsa në finale mundi italianen Nicole Rebecca, kategoria -60 kg. Është ky turneu i parë nën drejtimin e "World Boxing", në të cilin u përfaqësua Federata e Boksit e Kosovës. Paraqitje relativisht të mirë patën edhe boksierët e tjerë. Drejtësinë në këtë turne e ndau gjyqtari ynë ndërkombëtar Latif Demolli.

# Sonte gjysmëfinalja e parë në mes të Arsenalit dhe PSG-së

"Epoka e re"

**Londër, 28 prill** - Rikthehet përballja në mes të Arsenalit dhe PSG-së në gjysmëfinalet e Ligës së Kampionëve. Ish-kundërshtarët e fazës së grupeve, Arsenal dhe Paris Saint-Germain, do të përplasen sërish në superpërballjen e gjysmëfinales së Ligës së Kampionëve, ndeshja e parë e së cilës luhet sonte (e martë) në "Emirates Stadium". Të dyja skuadrat ëndërrojnë ta thyejnë më në fund mallkimin e gjatë pa një trofe evropian.
Skuadra e Mikel Artetës e eliminoi Real Madridin me një paraqitje të jashtëzakonshme, duke fituar 3-0 në shtëpi dhe më pas duke triumfuar 2-1 në "Santiago Bernabeu", për një rezultat total befasues 5-1 kundër rekordmenëve të këtij kompeticioni. Edhe pse pa një sulmues të mirëfilltë dhe pa Gabriel Magalhaes në mbrojtje, Arsenali tregoi pjekuri, disiplinë dhe dominim taktik ndaj një skuadre me përvojë të madhe në këtë kompeticion. Kjo është hera e tretë që "Topçinjtë" arrijnë në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve dhe e para që nga viti 2009. Historikisht ata kanë një përqindje 50 % suksesi në këtë fazë – pasi më 2006 shkuan në finale, por humbën ndaj Barcelonës, ndërsa më 2009 u eliminuan nga Manchester Unitedi. Forma e Arsenalit është mbresëlënëse: tetë ndeshje pa humbje në këtë edicion të Ligës së Kampionëve, një arritje që nuk e kanë përjetuar që nga sezoni 2005-06. Gjithashtu, ata janë të pamposhtur në 12 ndeshje në të gjitha garat. Megjithatë, një pikë dobësie vazhdon të jetë paaftësia për ta mbajtur avantazhin – një problem që u shfaq sërish në barazimin 2-2 me Crystal Palacen në Premierë Ligë.
Nga ana tjetër, PSG-ja e Luis Enrique eliminoi Aston Villën dhe më parë edhe Liverpoolin, duke treguar forcën e brezit të ri që ka në dispozicion. Gjithsesi, humbja 3-2 në Angli ndaj Aston Villës dhe disfatat e fundit në Ligën 1 – përfshirë humbjen befasuese ndaj Nices,



dëshmojnë se francezët nuk janë të pathyeshëm. PSG-ja ka shënuar në 18 ndeshje radhazi jashtë fushës në të gjitha garat, por nuk ia doli të shënojë në humbjen 2-0 kundër Arsenalit në fazën e grupeve më 1 tetor. Statistikat nuk janë në favorin e tyre: ata nuk e kanë mposhtur kurrë Arsenalin në pesë përballjet e mëparshme. Nëse Arsenali arrin ta ripërsërisë dominimin që pati ndaj Real Madridit, përballja me Barcelonën apo Interin në finalen e 31 majit do të jetë më shumë se një ëndërr – do të jetë një mundësi reale. Mungesat e Arsenalit për këtë ndeshje janë Gabriel, Kai Havertz, Takehiro Tomiyasu, Gabriel Jesus, Jorginho dhe Thomas Partey, kurse Riccardo Calafiori është në dyshim për këtë ndeshje. Në anën tjetër, PSG-ja ka qenë e bekuar me një gjendje perfekte fizike në këtë fazë të garës. Trajneri Luis Enrique pritet t'i ketë në dispozicion të gjithë lojtarët për udhëtimin në Londër, një avantazh i madh në këtë nivel të garës më të fortë në futboll.

**FORMACIONET E MUNDSHME:**

**Arsenal:** Raya, Timber, Saliba, Kiwior, Lewis-Skelly, Odegaard, Rice, Merino, Saka, Trossard, Martinelli.

**Paris Saint-Germain**: Donnarumma, Hakimi, Marquinhos, Pacho, Mendes, Ruiz, Vitinha, Neves, Barcola, Dembele, Kvaratskhelia.

# Chebbi dhe Camaras marrin çmimet MVP në Kupën e Kosovës





**Prishtinë, 28 prill** - Të gjithë finalistët e Kupës së Kosovës në hendboll shkëlqyen të dielën mbrëma në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj, por ishin disa që megjithatë u dalluan më shumë. Portieri nga Tunizia, Wadi Chebbi, shfaqi formë të lartë për Kastriotin në gjysmëfinale dhe në finale. Chebbi në fund u shpall lojtari më i vlefshëm (MVP) i Final 4 të Kupës së Kosovës. Ai pritet të jetë adut i rëndësishëm i Kastriotit edhe në "play-off" të kampionatit. Te hendbollistet, çmimi MVP i takoi Salemateu Camaras së Ferizajt. Ai pritet të jetë adut i rëndësishëm i Kastriotit edhe në play-off të kampionatit. Te hendbollistet, çmimi MVP i takoi Salemateu Camaras të Ferizajt. Hendbollistja nga Guinea shkëlqeu në gjysmëfinale dhe në finale, ndonëse skuadra e saj u mposht nga Istogu në ndeshjen vendimtare.

## Yllza Uka nis aventurën në ShBA




Prishtinë, 28 prill - Lojtarja premtuese Yllza Ukaj, pas shumë viteve me Junior 06 Moni Bau, ka vendosur ta vazhdojë rrugëtimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo rrëfen se ëndrra për të luajtur në ShBA nisi vite më parë, ndërsa falë mbështetjes së familjes dhe trajnerëve, arriti ta realizojë. Yllza tregon se largimi nga Kosova dhe shoqet e fëmijërisë ishte i vështirë, por përvoja e re i dha edhe më shumë motivim. Ajo thekson ndryshimet e mëdha mes dy sistemeve, sidomos në kushtet dhe zhvillimin e sportistëve. Pavarësisht prej mallëngjimit për familjen dhe miqtë, Yllza mbetet e vendosur të ndërtojë një karrierë të suksesshme në Evropë dhe ta përfaqësojë Kosovën me krenari. Ajo u dërgon një mesazh të gjitha vajzave të reja: "Mos ndalni kurrë së ndjekuri ëndrrën tuaj pavarësisht prej pengesave".

## Messi nuk planifikon rikthimin te Barcelona

Barcelonë, 28 prill - Lionel Messi e ka bërë të qartë se, për momentin, ai nuk është i fokusuar në ndonjë lidhje të menjëhershme me Barcelonën. Pavarësisht prej dashurisë së tij të thellë për klubin, ai nuk po mendon për një rikthim, as ndonjë njohje institucionale, në këtë pikë, sipas SPORT. Messi, i cili gjithmonë ka folur mirë për kohën e tij në Barcelonë, po synon të kthehet për të jetuar në qytet pasi të përfundojë karriera e tij si lojtar. Megjithatë, ai aktualisht po shmang çdo ndërveprim me drejtuesit e klubit dhe është distancuar nga mediet, duke bërë të qartë se nuk ka asnjë mundësi për rikthim të shpejtë apo ribashkim me hierarkinë e klubit. E ardhmja e tij me Inter Miamin duket se është në një gjendje të qëndrueshme, me një rinovim që duket i mundshëm. David Beckhami dhe klubi janë të etur që të kenë Messin si figurë qendrore kur ta hapin stadiumin e tyre të ri vitin e ardhshëm, që përkon me Kupën e Botës 2026 në Shtetet e Bashkuara. Duke parë më tej, MLS po planifikon ndryshime në kalendarin e saj, ndoshta duke e përafruar atë me ligat evropiane nga gushti deri në maj. Ndryshimi nuk do të hynte në fuqi deri në vitin



2027, duke lejuar Messin të vazhdojë të luajë në ligë edhe për disa vjet të tjera përpara se të ndodhë ndonjë ndryshim i madh.

# Slot: Speciale ta fitosh titullin me tifozët, meritë edhe e Kloppit

Liverpool, 28 prill - Arne Slot është trajneri i pestë që fiton Premierë Ligën në sezonin e tij të parë në Angli, pas Mourinhos (2004-05), Ancelottit (2009-10), Pellegrinit (2013-14) dhe Contes (2016-17). "Është e vështirë ta shpjegoj me fjalë. Pamjet këtu dhe ato para ndeshjes tregojnë më shumë sesa mund të përshkruaj unë. Prania e tifozëve është ajo që e bën këtë moment kaq të veçantë. Para 3-4 vjetësh ata fituan titullin, ishte një arritje e jashtëzakonshme, por tifozët nuk ishin aty. Kështu që ndien se sa e rëndësishme ishte për ta të ishin të pranishëm. Djemtë bënë një punë të jashtëzakonshme, bashkë me tifozët tanë", ka thënë tekniku holandez, që mori mikrofonin përpara tifozëve dhe thërriti edhe emrin e Klopit.



Slot, i cili u bë edhe trajneri i parë holandez që fiton Premierë Ligën, nuk pati asnjë dyshim te skuadra e tij: "Pësimi i golit nuk ishte ideal, por unë u besoj lojtarëve të mi. Ata gjithmonë gjejnë një mënyrë për të fituar. Nuk mendoja se mund ta humbnim këtë ndeshje. Nëse ishe në këtë stadium, e ndieje qartë. Fokusi ynë kryesor ishte të fitonim këtë ndeshje. Të gjithë thoshin se ne tashmë e kishim fituar titullin, por ne ende ndienim presionin për ta siguruar matematikisht. Gjatë gjithë sezonit kemi qenë pothuajse gjithmonë në krye të tabelës. E dimë sa e vështirë është Premierë Liga, por gjithmonë kemi pasur besimin se mund ta fitonim". "Puna që kishin lënë Kloppi dhe Lijndersi, kultura, përkushtimi, cilësia, ishte e jashtëzakonshme. Na ndihmoi edhe periudha e vështirë e Cityt. Kur nisi sezoni do t'i pranonim katër vendet e para, por kjo nuk do të ishte e drejtë për lojtarët, sepse janë shumë më të mirë se kaq dhe këtë e kanë treguar këtë sezon", ka deklaruar Slot.

# Oklahoma, skuadra e parë gjysmëfinaliste, lakersat dhe Milwaukee rrezikojnë eliminimin

Los Anxhelos, 28 prill - Oklahoma bëhet skuadra e parë në NBA që shkon në gjysmëfinalet "play-off". Në Konferencën e Perëndimit, skuadra e Thunderit fitoi me rezultat 117-115 ndaj Memphisit, duke fituar 4-0 serinë. Alexander Shai me 38 pikë ishte më i miri në fushë. Rrezikon eliminimin ekipi i lakersve, që u mund me rezultat 116-113 nga Minnesota, që tashmë udhëheq 3-1 serinë. Anthony Edwards me 43 pikë ishte lider në fushë, ndërsa 38 pikët e Luka Donqiqit nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. 3-1 udhëheq serinë Bostoni, që mundi me rezultat 107-98 Orlandon. Për kampionët u dallua Jayson Tatum me 37 pikë. Po në Lindje ekipi i Indianas fitoi me rezultat 129-103 ndaj Milwaukees (8 lojtarë realizuan mbi 10 pikë) dhe udhëheq 3-1 serinë e çerekfinaleve.



**KONFERENCA E LINDJES-ÇEREKFINALE**

| | |
|---|---|
| Cleveland - Miami | (3-0) |
| Boston - Orlando | 108-98 (3-1) |
| New York - Detroit | 94-93 (3-1) |
| Indiana - Milwaukee | 129-103 (3-1) |

**KONFERENCA E PERËNDIMIT-ÇEREKFINALE**

| | |
|---|---|
| Oklahoma - Memphis | 117-115 (4-0) |
| Houston - Golden State | (1-2) |
| Lakers - Minnesota | 113-116 (1-3) |
| Denver - Clippers | (2-2) |

## SHKURT

### Beshiktashi dëshiron ta mbajë Rashicën

Futbollisti i Kosovës, Milot Rashica, ka gjasa të mbetet pjesë e skuadrës së Beshiktashit edhe pas përfundimit të sezonit aktual. Raportohet se drejtuesit e klubit turk duan ta mbajnë Rashicën edhe për sezonin e ardhshëm pas paraqitjeve të mira në ndeshjet e fundit. Më herët Rashica ishte në listën e lojtarëve që do të largoheshin nga Beshiktashi në verë, por 28-vjeçari duket se e ka bindur edhe trajnerin Ole-Gunnar Solskjaer. 28-vjeçari këtë sezon ka shënuar 4 gola dhe ka bërë 11 asistime në të gjitha garat për Beshiktashin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2027. Ai është pjesë e ekipit turk prej vitit 2023, kurse karrierë ka bërë edhe te Galatasary, Norwich City, Werder Bremeni e Vitesse.

### Hamiltoni: Në vitin 2026 do të jemi më kompetitivë

Botërori i Formulës 1 rikthehet këtë fundjavë në Majemi, por për 7 herë kampionin e botës Lewis Hamilton kjo garë pritet të jetë si të mëparshmet. Piloti pranon se ka vështirësi për t'u përshtatur me makinën Ferrari SF-25. Zhgënjimi i kampionit anglez është i madh, aq sa ai deklaroi se ishte më shumë se 30 sekonda pas shokut të tij të skuadrës Charles Leclerc. "Charles e ka drejtuar këtë makinë për një kohë të gjatë, kështu që e njeh shumë mirë", ka thënë Hamiltoni. "Mund të shihni shumë nga të dhënat, por nuk janë shumë të ndryshme, përveç faktit që jam më i ngadaltë në kthesa. Kemi konfigurime paksa të ndryshme. Duhet ta kuptoj nëse i imi i pëlqen makinës. Por Charles po bën padyshim një punë më të mirë", ka shtuar britaniku. "Kjo epokë, me këto makina, për mua është më e keqja. Shpresoj që në vitin 2026 me më pak efekt tokësor, gjërat të ndryshojnë pak më mirë dhe të jem më kompetitiv", ka deklaruar Hamiltoni.

### Bayerni pranon largimin e Kim Min-Jae për 40 milionë euro

Pas vetëm dy sezonesh, aventura e mbrojtësit Kim Min-Jae te Bayern Munich mund të mbyllet. Skuadra "bavareze" është shprehur e gatshme të ndahet nga 28-vjeçari këtë verë edhe pse ai ka një kontratë që zgjat deri në vitin 2028.
Sipas raportimeve nga Gjermania, Kim Min-Jae vlerësohet rreth 40 milionë euro nga "bavarezët". Edhe vetë qendërmbrojtësi është gati të dëgjojë çdo ofertë që vjen nga Arabia Saudite. Janë pikërisht klubet arabe ato që janë më së shumti të interesuara për mbrojtësin, që në 79 ndeshje zyrtare me Bayernin ka realizuar 4 gola. Duket se mes lojtarit dhe tifozëve asnjëherë nuk lindi një dashuri e madhe. Madje shpesh koreano-jugori ka përfunduar në qendër të kritikave.

## Alonso: Asnjë presion për të ardhmen time, së shpejti do të mësoni gjithçka

Trajneri i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, është shprehur se situata është "e qartë" për të ardhmen e tij, por tifozët ende nuk e dinë atë. Ata do të duhet të presin për të parë nëse ai do të qëndrojë në klubin gjerman apo jo. Alonso është një nga kandidatët kryesorë për ta marrë përsipër drejtimin e Real Madridit nëse Carlo Ancelotti largohet nga klubi spanjoll ashtu sikurse pritet. Trajneri spanjoll është lidhur prej kohësh me këtë transferim. "Unë gjithmonë kam thënë se komunikimi im me Simon Rolfes (drejtor sportiv i Leverkusen) dhe Fernando Carro (CEO i Leverkusen) është shumë i qartë. Dhe kur ka diçka për të vendosur, ne do të jemi shumë të drejtpërdrejtë", ka thënë Alonso. "Besimi midis nesh ka qenë gjithmonë shumë i rëndësishëm dhe mbetet i tillë. Nuk ka presion për kohën e marrjes së një vendimi. Situata është e qartë. Ka një moment për gjithçka. Kështu që duhet të presim pak", ka deklaruar Alonso.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
Përparimi
Vushtrri

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr. Protokollit: 742/25
Data: 28.04.25

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 741/25 të datës **28.04.2025** të **Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A,** me datë **28.04.2025** shpall:

**KONKURS PUBLIK**

**I. Titulli:** Pastrues i Zyrave dhe Objekteve
**Numri i ekzekutuesve:** 4
**Orët e punës:** 40 orë në javë
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
**Përgatitja profesionale:** Shkolla fillore
**Përvoja e punës:** Nuk kërkohet përvojë pune
**I raporton:** Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
**Koeficienti i pagës:** 390.00 €uro Bruto

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:**

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

**Aplikacionit i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

**➢ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

**➢ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

**➢ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:**

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

**➢ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data **29.04.2025** deri me datë **13.05.2025** në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë **21.05.2025**.
- Afati për ankesë nga data **22.05.2025** deri me datë **26.05.2025**.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **05.06.2025**.
- Afati për ankesë nga data **09.06.2025** deri me datë **12.06.2025**.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **23.06.2025**.
- Afati për ankesë nga data **24.06.2025** deri me datë **26.06.2025**.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu **11.07.2025**.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**➢ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët**

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

**Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.**

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

**Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.**

**➢ Sqarim**

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

**➢ Përfundim**

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florim Kajdomqaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Luciano Motroni", në Prizren.

- Qëndrim Hasanaj nga Skivjani shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 të lëshuar nga SH.F.M.U "Ukshin Miftari", Skivjan Gjakovë.

- Melisa Nrejaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale "Selajdin Mullaabaz-Mici", Rahovec.

- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
Përparimi
Vushtrri

U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, a na osnovu rješenja br. protokola 741/25 od **28.04.2025**.godine glavnog izvršnog direktora, NPL "Përparimi" Sh. A od **28.04.2025** saopštava:

**JAVNI KONKURS**

I. **Naslov:** Čistač kancelarija i objekata
**Broj izvršilaca:** 4
**Radno vrijeme:** 40 sati sedmično
**Trajanje termina:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
**Stručna priprema:** Osnovna škola
**radno iskustvo:** Nije potrebno radno iskustvo
**Izvještava:** Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata
**Koeficijent plate:** 390.00 €uro Bruto

**Opis radnih obaveza i odgovornosti:**

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

**Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:**

- Prijavni obrazac za NPL "Progres" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

**➢ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti**

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

**➢ Način vrednovanja kandidata.**

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

**➢ Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:**

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

**➢ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.**

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od **29.04.2025** do **13.05.2025** u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do **21.05.2025**.
- Rok za žalbu je od **22.05.2025** do **26.05.2025**.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do **05.06.2025**
- Rok za žalbu je od **09.06.2025** do **12.06.2025**.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do **23.06.2025**.
- Rok za žalbu je od **24.06.2025**. do **26.06.2025**.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do **11.07.2025**.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

**➢ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima**

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Peparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

**Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.**

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

**Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.**

**➢ Objašnjenje**

